



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 3 shkurt 2016, në mbledhjen XX – të (njëzetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.10’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti Bahri Selimi, Shaban Osmani, Radisav Perović, Xhafer Ademi, Mefail Rama dhe Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Nexhmedin Feta, Policia Kufitare, Bekim Karaxhija OSBE dhe Nevzat Qorrolli dhe Xhavit Fejza, UNMIK (OLSF) .

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 6 nëntor 2015 dhe 7 dhjetor 2015

Ekstraktet e procesverbalit u miratuan njëzëri.

3. Shqyrtimi i propozimit të Raportit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2015

Raporti i punës u miratua njëzëri.

4. Shqyrtimi i Planit të punës të Komitetit për Komunitete për viti 2016

z. Shaban Osmani, në emër të Grupit punues për hartimin e propozimit të Raportit të punës për vitin 2015 dhe propozimit të Planit të punës për vitin 2016, e paraqiti fjalën e hyrjes, përkatësisht e lexoi propozimin e Planit të punës.

Pas leximit kërkoi nga të pranishmit të paraqesin sugjerimet, vërejtjet dhe plotësimet për të cilat mendojnë se do ta begatojnë këtë dokument.

z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, theksoi, propozimi i Planit të punës i Komitetit për Komunitete përfshinë të gjitha çështjet esenciale dhe konsideroj se i njëjti mund të mbështetet dhe pas miratimit duhet të ndërmerren aktivitetet përkatëse për zbatimin e tij.

Pajtohem me shumën e paraparë buxhetore ngase disa planifikime të cilat po i miratojmë nuk po kemi mundësi me i realizuar mu për shkak të mungesës së mjeteve financiare, andaj duhet angazhuar që kjo çështje të mbështetet edhe nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës.

z. Bahri Selimi, theksoi, Grupi punues për hartimin e propozimit të këtij Plani me qëllim nuk ka propozuar çështje për shqyrtim për muajin nëntor në mënyrë që bashkërisht të propozojmë pika të rendit të ditës për të cilat konsiderojmë se janë të rëndësishme për shqyrtim.

Duke u bazuar se ky Plan pune do të shqyrtohet edhe në Kuvend të Komunës jam i mendimit se muaji nëntor do duhej të plotësohej me çështje konkrete të cilat do të shqyrtohen, ngase është e arsyeshme që mund të bëhen vërejtje përse nuk janë paraparë çështje për shqyrtim për mbledhjen e muajit përkatës.

z. Xhevdet Beselica, theksoi, e kam lexuar propozimin e Planit të punës të këtij Komiteti, i dëgjova fjalën hyrëse dhe diskutimet paraprake dhe mbi bazën e tyre e vlerësoj mjaft lartë punën e Grupit punues ngase jam i mendimit se është një Plan pune i cili me përmbajtjen dhe formën e këtillë mund të themi se nuk e ka as Kuvendi i Komunës, andaj jam i bindur se do të gjejmë mirëkuptim edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa por edhe në Kuvend që ky plan të miratohet.

Pajtohem me diskutuesit e mëparshëm që edhe mbledhja e planifikuar për muajin nëntor të plotësohet me propozime konkrete për shqyrtim në mënyrë që planifikimi të jetë i plotë për tërë vitin.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, nëse ndokush ka propozime konkrete ne mund t'i mbështesim, por në të kundërtën, për muajin e mbledhjes së nëntorit, mund të parashohim shqyrtimin e çështjeve sipas nevojës.

z. Shaban Osmani, theksoi, sa i përket çështjes financiare që ndërlihet me këtë Plan pune, tre anëtarë të këtij Komiteti njëherit jemi edhe këshilltarë të Kuvendit dhe sigurisht se do të angazhohemi për miratimin e të njëjtit duke përfshirë edhe aspektin financiar.

z. Xhevdet Beselica, theksoi, në diskutimin e mëparshëm e mbështeta këtë Plan të punës, sipas mendimit tim, plotësimi i vetëm i këtij Plani do të ishte që të parashihet edhe një vizitë studimore jashtë vendi, kjo do të ishte një mundësi që anëtarët e këtij Komiteti të shkëmbejnë përvoja dhe të informohen për praktikatat të cilat i zbaton ndonjë shtet tjetër.

z. Shaban Osmani, e mbështeti propozimin e parafolësit dhe propozoi që në formë të shkruar të kërkohet nga Ekzekutivi i Komunës, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe OSBE – së, për shqyrtimin e mundësive të sigurimit të mjeteve financiare për realizimin e vizitës së cekur studimore jashtë vendi.

z. Bekim Karaxhija, përfaqësues i OSBE – së, theksoi, jemi të mendimit me diskutuesit e mëparshëm se Plani i punës është gjithëpërfshirës dhe i detajuar dhe në veçanti e vlerësojmë përfshirjen e aspektit financiar për realizimin e aktiviteteve përkatëse.

Sa i përket sigurimit të donacionit për vizitën studimore mund të them se jo vetëm OSBE – ja por edhe subjektet tjera ndërkombëtare, sidomos prej shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, gradualisht kompetencat i kanë bartur në organet dhe institucionet vendore, qoftë në ato qendrore apo lokale.

Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin tonë të mirëfilltë sikur deri më tash, e mirëpresim çdo kërkesë dhe do të bëjmë përpjekje për ofrimin e çdo ndihme të mundshme, por duhet të keni në konsideratë se edhe OSBE – ja tani i ka disa kufizime sa i përket aspektit financiar.

Plani i punës parasheh që për çdo muaj të shqyrtohen çështjet konkrete, mirëpo sigurisht se në punët dhe aktivitetet e ardhshme do të bëhen edhe kërkesa të tjera por edhe do të paraqitet nevoja edhe për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme, andaj mendimi im është se nuk duhet të paraqes problem nëse ndonjë çështje e planifikuar shtyhet për një muaj përkatësisht për mbledhjen e radhës.

Në fund e kam një propozim dhe atë që të parashihet një vizitë në nivelin qendror, qoftë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal apo në ndonjë Ministri tjetër.

Plani i Punës u miratua njëzëri.

5. Shqyrtimi i mundësive për ofrimin e ndihmës financiare (Miratimin e rekomandimit) për organizimin e festës së flamurit të komunitetit ashkali.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Xhafer Ademi, theksoi, duke u bazuar në rëndësinë për organizimin e festës së flamurit të komunitetit ashkali, në formë të shkruar ju kam drejtuar për ndihmë financiare Drejtorisë për buxhet dhe Financa dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, por ende nuk kam marrë përgjigje.

z. Xhevdet Beselica, theksoi, jam i mendimit se të gjithë e mbështesim çështjen për të cilën jemi duke debatuar, andaj propozoj që rekomandimi përkatës të hidhet në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Ekzekutivit të Komunës që të shqyrtojë mundësit për ofrimin e ndihmës financiare për organizimin e festës së flamurit të komunitetit ashkali në shumë 600 €.

6. Të ndryshme

z. Mefail Rama, theksoi, më 1 shkurt 2016, nga pjesëtarët e KFOR – it jam informuar se një pjesëtare e komunitetit rom 26 vjeçare ka protestuar me grevë urie e cila është riadhesuar tri herë e herën e fundit më 14 dhjetor 2015 dhe tani e vetme ka mbetur pa strehim dhe për momentin është në rrugë, ajo përveç gjuhës angleze dhe gjuhës amtare nuk e flet asnjë gjuhë tjetër.

Për këtë rast është njoftuar Zyrtari për riadhesim, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, mirëpo deri tani nuk është bërë ndonjë zgjidhje por çështja është në procedurë e sipër.

z. Shaban Osmani, u interesua se e përmendura ku jeton dhe a është paraqitur me kërkesë për ndihmë sociale në Qendrën për Punë Sociale.

z. Mefail Rama, theksoi, e përmendura ka jetuar tek një fqinjë i cili po ashtu është në gjendje të rëndë sociale dhe nuk ka mundësi që edhe më tutje të kujdeset për të.

z. Xhafer Ademi, theksoi, për çështjen të cilën e ngriti parafolësi u informova tani, mirëpo konsideroj se nuk është në rregull që vajza e përmendur t'i mbetet në barrë një personi i cili ka vështirësi të siguroj ekzistencën e familjes së tij, andaj do duhej që sa më parë me këtë çështje të merren institucionet kompetente komunale.

Mbledhja përfundoi në orën 12.00'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01-006- 14853
Podujevë,
3 shkurt 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**